



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 01 Maj 2021

Nr: 330

**VENDIM**

**PËR**

**SHQYRTIMIN E REZULTATIT TË VERIFIKIMIT TË PROKURORISË SË  
PËRGJITHSHME PËR SUBJEKTIN VETËDEKLARUES Z. ADRIAN VULLNET  
GJOKA, KANDIDAT PËR DEPUTET I SUBJEKTIT ZGJEDHOR LËVIZJA PËR  
NDRYSHIM, QARKU VLORË, NË ZBATIM TË LIGJIT NR. 138/2015 “PËR  
GARANTIMIN E INTEGRITETIT TË PERSONAVE QË ZGJIDHEN, EMËROHEN OSE  
USHTROJNË FUNKSIONE PUBLIKE”**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të pikës 12, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pasi shqyrtova dokumentacionin e paraqitur nga Prokurori i Përgjithshëm me shkresën nr. 550/54 prot., datë 21.04.2021, me lëndë “Dërgohet Vendimi për miratimin e rezultateve të verifikimit” për subjektin vetëdeklarues z. Adrian Vullnet Gjoka, kandidat për deputet i Partisë Lëvizja për Ndryshim, Qarku Vlorë,

**VËREJ:**

**I.**

Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme për subjektin vetëdeklarues z. Adrian Vullnet Gjoka, kandidat për deputet i subjektit politik, partia Lëvizja për Ndryshim, Qarku Vlorë, në zbatim të ligjit nr. 138/2015

Data: 01 Maj 2021

Nr. 330



Në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin për funksionet publike si dhe përpunimin për formularin e vetëdeklarimit për subjekte si më poshtë:

- Deputetë të Kuvendit të Shqipërisë;
- Kryeministrit apo anëtarit të Këshillit të Ministrave që nuk është deputet;
- Kryetarit të bashkisë apo këshilltarit në këshillin bashkiak;
- Kandidatët për deputet dhe në organet e qeverisjes vendore.

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, z. Adrian Vullnet Gjoka, kandidat i listës shumëmërore të subjektit politik Lëvizja për Ndryshim, Qarku Vlorë, në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021, ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, formularin e vetëdeklarimit me numër 3001 unik.

- i. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 2172 prot., datë 17.03.2021 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore dhe me shkresën nr. 2174 prot., datë 17.03.2021, ka kërkuar informacion zyra e gjendjes civile.
- ii. Me shkresën nr. 2793/1 prot., datë 17.03.2021, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve informon Komisionin Qendror të Zgjedhjeve kandidati për deputet z. Adrian Vullnet Gjoka, nuk ka të regjistruar dënime penale të formës së prerë në sistem.
- iii. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile nuk i ka kthyer ende përgjigje shkresës tonë.
- iv. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 158 datë 17.03.2021, vendosi Miratimin e listave shumëmërore të kandidatëve për deputetë, të Partisë Lëvizja për Ndryshim, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021, për zonat zgjedhore, Qarku Berat, Qarku Dibër, Qarku Durrës, Qarku Elbasan, Qarku Fier, Qarku Gjirokastrë, Qarku Korçë, Qarku Kukës, Qarku Lezhë, Qarku Shkodër, Qarku Tiranë dhe Qarku Vlorë.

## II.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, verifikoi të dhënat në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për deputet z. Adrian Vullnet Gjoka.



Data: 01 Maj 2021  
Nr. 330

Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme për subjektin vetëdeklarues z. Adrian Vullnet Gjoka, kandidat për deputet i subjektit politik, partia Lëvizja për Ndryshim, Qarku Vlorë, në zbatim të ligjit nr. 138/2015

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Adrian Vullnet Gjoka, rezulton se ka deklaruar:

➤ Në rubrikën III. “TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT”, të Formularit të Vetëdeklarimit,

**Pyetjes 2**, “A jeni dënuar me burgim me vendim gjyqësor jopërfundimtar nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj, për një çështje penale të pazgjidhur me vendim gjyqësor të formës së prerë?”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “Po” duke deklaruar se:

- Me vendimin nr. 654, datë 05.03.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është dënuar për veprën penale të parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal. Vendimi është ankimuar në Gjykatën e Apelit Tiranë.

**Pyetjes 8** “A keni jetuar ndonjëherë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për më shumë se 1 muaj?”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “Po” duke deklaruar se:

- Nga viti 1992 deri në vitin 1994 ka qendruar në Trier, Gjermani për arsye emigracioni.
- Nga viti 2000 deri në vitin 2002 ka qendruar në Romë, Itali për arsye emigracioni.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, referuar deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit si dhe përgjigjes të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve ku deklarohet se, z. Adrian Vullnet Gjoka nuk ka të dhëna në sistem por subjekti vetëdeklarues deklaroi në formularin e vetëdeklarimit se ka një vendim gjyqësor jo të formës së prerë si dhe bazuar në nenin 8, pika 1, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e Integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreu V, pika 2, shkronja “c”, të Vendimit të Kuvendit, nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, vendosi t’ja kalojë rastin për verifikim të thelluar Prokurorisë së Përgjithshme, si institucioni kompetent që kryen verifikimin e plotë të deklarimeve të bëra.

Më shkresën nr. 550/54, datë 21.04.2021, Drejtoria e Koordinimit Institucional, Sektori i Dekriminalizimit pranë Prokurorisë së Përgjithshme, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, vendimin e rezultatit të verifikimit për subjektin vetëdeklarues, z. Adrian Vullnet Gjoka, kandidat për deputet i Partisë Lëvizja për Ndryshim, qarku Vlorë.



Sipas vendimit të Prokurorisë së Përgjithshme “Për miratimin e rezultatit të Verifikimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015 për subjektin vetëdeklarues, z. Adrian Vullnet Gjoka, kandidat për deputet i Partisë Lëvizja për Ndryshim, qarku Vlorë”, rezulton se Prokuroria e Përgjithshme i është drejtuar institucioneve të ndryshme për verifikim të mëtejshëm duke deklaruar si më poshtë:

- Në përgjigje të kërkesës sonë, nr. 550/2 prot., datë 29.03.2021, përjashtuar Prokurorinë e Shkallës së Parë dhe Apelit Tiranë, Prokuroritë e tjera pranë Gjykatave të Shkallës së Parë dhe Gjykatave të Apelit, si dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Posaçme kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit, kanë informuar se, ndaj subjektit Adrian Vullnet Gjoka:
  - Nuk janë regjistruar procedime penale;
  - Nuk ka qenë ose është nën hetim;
  - Nuk është caktuar ndonjë masë sigurimi;
  - Nuk është dënuar me vendim jopërfundimtar apo të formës së prerë për kryerjen e ndonjë veprë penale.
- Në përgjigje të kërkesës sonë, nr. 550/2 prot., datë 29.03.2021, Prokuroria e Shkallës së Parë Tiranë, me shkresën nr.4056/1, datë 02.04.2021, ka informuar se: “Nga verifikimi i kryer në indeksat e kallëzimeve dhe statistikave elektronike të procedimeve penale për periudhën kohore 2011-2021, për shtetasin Adrian Vullnet Gjoka rezulton të jetë regjistruar procedimi penal nr. 9030, datë 02.11.2017, për veprën penale “Falsifikim i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186/1, i Kodit Penal, i cili është dërguar për gjykim më datë 26.02.2019”.

Bashkëlidhur, kësaj shkrese Prokuroria e Shkallës së Parë Tiranë ka dërguar dhe kopje të njësuar me origjinalin të vendimit nr.654, datë 05.03.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila ka vendosur ndër të tjera:

- “Deklarimin fajtor të të pandehurit Adrian Vullnet Gjoka, për veprën penale të “Falsifikimit të dokumentave”, dhe në bazë të nenit 186/1 i Kodit Penal dënimin e tij me 3 (tre) muaj burgim;
  - Vuajtja e dënimit i fillon nga data e ekzekutimit të vendimit dhe kryhet në një burg të sigurisë së zakonshme”.
- Në përgjigje të kërkesës sonë, nr. 550/2 prot., datë 29.03.2021, Prokuroria e Apelit Tiranë, me shkresën nr. 274/1 prot., datë 09.04.2021, ka informuar se: “Sipas verifikimit të kryer në regjistrat penalë për shtetasin Adrian Gjoka, i datëlindjes 15.09.1968, rezulton e regjistruar dhe e pagjykuar çështja penale nr. 53801-00824-30-2020 sistem nr. 3712 akti, datë



07.05.2020 me palë të pandehur Adrian Gjoka, e regjistruar pranë Gjykatës së Apelit Tiranë por deri në datë 02.04.2021, nuk është planifikuar për gjykim”.

- Drejtoria e përgjithshme e Gjendjes Civile, me shkresën nr. 1375/1 prot., datë 07.04.2021, ka informuar se, “pas verifikimeve të kryera në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGJC) të vitit 2010 dhe me zyrën përkatëse të gjendjes civile: për shtetasin Adrian GJOKA, me emrin e babait Vullnet dhe emrin e nënës Izmini, lindur në Tiranë, më datë 15.09.1968, i cili figuron të jetë i regjistruar banor në zyrën e gjendjes civile në Njësinë Bashkiake nr.7, Njësia Administrative Tiranë, Bashkia Tiranë, konstatohet se nuk ka kryer ndryshime në përbërësit e gjendjes civile.”
- Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve me shkresën nr. 3440/1 prot., datë 01.04.2021 ka paraqitur në Prokurorinë e Përgjithshme dokumentin “Vërtetim i Gjendjes Gjyqësore nr. 11 prot., datë 31.03.2021. Nga ky dokument informohemi se shtetasi Adrian (Vullnet) Gjoka, i biri i Vullnet dhe Izmini, lindur më datë 15.09.1968, në Tiranë, është i Padënuar.
- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Departamenti i Policisë Kriminale, me shkresën e datës 07.04.2021, ka informuar se nga të dhënat e grumbulluara në sistemin elektronik, subjekti **Adrian Vullnet Gjoka**, lindur në datë 15.09.1968:
  - Nuk figuron i ndaluar apo arrestuar nga strukturat e policisë;
  - Nuk ka gjenealitete të tjera të regjistruara për këtë shtetas, përvec sa ka deklaruar;
  - Nga verifikimi në arkivin elektronik të Interpol Tiranë, nuk rezulton të ketë të dhëna për arrestime/ndalime apo vendime për masa sigurie, si dhe nuk rezulton të ketë urdhër kërkimi ndërkombëtar.
- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me shkresën nr. 881/1 prot., datë 06.04.2021, ka bërë me dije se: “Vendimi penal nr. 654, datë 05.03.2021 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ku është vendosur ndër të tjera: “Deklarimi fajtor i të pandehurit Adrian Vullnet Gjoka, për veprën penale të “Falsifikimit të dokumenteve” dhe në bazë të nenit 186/1 të Kodit Penal dënimi i tij me 3 (tre) muaj burgim...”, në sistem është me statusin ankimuar dhe nga Gjykata e Apelit Tiranë nuk kemi dijeni për vendimmarrjen lidhur me këtë çështje. Po nga verifikimet e tjera të kryera në Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve penale të gjykatës në emër të shtetasit Adrian Vullnet Gjoka, dtl. 15.09.1968 për periudhën 2015-2021, nuk ka vendim penal tjetër të dhënë si dhe nuk ka çështje apo kërkesë penale në gjykim”.
- Gjykata e Apelit Tiranë, me shkresën nr. 1596/1 prot., datë 31.03.2021, ka informuar se “pranë kësaj Gjykate është regjistruar çështja penale e gjykatës së Rrethit Tiranë me nr. 654 vendimi datë 05.03.2020, për veprën penale “Falsifikim i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal, me nr. 3712 akti, nr. 53801- 00824-30-2020 çështje (sistemi) datë

Data: 01 Maj 2021

Nr. 330

Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme për subjektin vetëdeklarues z. Adrian Vullnet Gjoka, kandidat për deputet i subjektit politik, partia Lëvizja për Ndryshim, Qarku Vlorë, në zbatim të ligjit nr. 138/2015



regjistrimi 07.05.2020. Kjo çështje është ndarë me short dhe pret radhën e planifikimit për gjykim.”

- Drejtorja e Bashkëpunimit dhe Koordinimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, me shkresën e datës 06.04.2021, ka informuar se: “Nga verifikimet e bëra në arkivën e ZQK Interpol Tirana, për këtë shtetas nuk figuron të jenë të regjistruara praktikantët me zyrat homologe për përfshirje në veprimtari kriminale. Shtetasi Adrian Gjoka nuk figuron person i shpallur në kërkim ndërkombëtar, nga verifikimet e bëra më datë 07.04.2021.
- Departamenti për Kufirin dhe Migracionin në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, me shkresën nr. 1145/1 prot., datë 12.04.2021, ka informuar se: “Nga konsultimi me sistemin e informacionit TIMS, Adrian Gjoka, me atësi Vullnet dhe amësi Izmini, lindur më datë 15.09.1968 në Tiranë dhe banues në Tiranë, nuk ka asnjë shënim si për deportiv apo dhe shënime të tjera”.
- Nga verifikimet e kryera në sistemin TIMS, rezulton se subjekti Adrian (Vullnet) Gjoka:
  - ka ato gjenealitete, të cilat i ka deklaruar në Formularin e Vetëdeklarimit dhe që janë konfirmuar nga Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile;
  - nuk rezulton të jetë ndonjë person tjetër me këto të dhëna;
  - nuk figuron i ndaluar /arrestuar nga organet policore për kryerjen e ndonjë vepre penale;
  - nuk figuron si person i dëbuar nga territori i një shteti tjetër apo që të ketë urdhër kërkimi ndërkombëtar në ngarkim të tij.
- Prokuroria e Përgjithshme në shkresën e saj referon se, në mungesë të indicieve apo të dhënave që do të justifikonin një verifikim jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë si dhe pas kryerjes së gjithë verifikimeve të mundshme brenda vendit, i konsideron këto verifikime të plota, bazuar në përcaktimet e nenit 8, pika 1,2 të lidhura me nenin 5 të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” si dhe në përcaktimet e pikës 3 shkronja “ç”, Kreu III dhe pikave 10,11, 12 e 13 të Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016.

### III.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit dhe rezultatit të verifikimit të ardhur nga Prokuroria e Përgjithshme vlerëson se:



Data: 01 Maj 2021  
Nr. 330

Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme për subjektin vetëdeklarues z. Adrian Vullnet Gjoka, kandidat për deputet i subjektit politik, partia Lëvizja për Ndryshim, Qarku Vlorë, në zbatim të ligjit nr. 138/2015

- Subjekti vetëdeklarues z. Adrian Vullnet Gjoka, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, ka plotësuar pikën 2 dhe 8 të formularit të vetëdeklarimit.

Prokuroria e Përgjithshme, me shkresën nr. 550/54 prot., datë 21.04.2021, administruar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me nr. 2686/1 prot., datë 22.04.2021, me lëndë “Dërgohet vendimi për miratimin e rezultateve të verifikimit”, në lidhje me subjektin deklarues si z. Adrian Vullnet Gjoka referon se:

- Nuk rezulton të ketë gjenealitete të tjera në përbërësit e gjendjes civile, përveç atyre të deklaruara në formular apo të ndryshme nga ato të deklaruara;
- Nuk rezulton të jetë i dënuar me vendim të formës së prerë nga ndonjë autoritet gjyqësor shqiptar, për kryerjen e një vepre penale;
- Rezulton të ketë qenë person nën hetim dhe i akuzuar për kryerje të veprës penale “Falsifikim i dokumenteve” të parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal, në procedimin penal nr. 9030 të regjistruar më datë 02.11.2017, nga Prokuroria e Shkallës së Parë Tiranë, e cila e ka dërguar për gjykim çështjen me datë 26.02.2019;
- Rezulton të jetë i dënuar me 3 (tre) muaj burgim, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin gjyqësor jo përfundimtar, nr. 654, datë 05.03.2021, për veprën penale të “Falsifikimit të Dokumenteve” parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal;
- Nuk rezulton të ketë qenë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese për kryerjen e një vepre penale;
- Nuk rezulton të ketë qenë i siguruar me masë shtrënguese të sigurisë personale;
- Nuk rezulton të ketë indicie apo fakte rrethana apo informacion me qëllim verifikimi:
  - a. Për veprimtari kriminale të kryera jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
  - b. Për qenien nën hetim apo gjykim nga një autoritet i huaj;
  - c. Për urdhër kërkimin ndërkombëtar për kryerjen e një vepre penale prej tij;
  - d. Dëbimi nga territori i një shteti jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
  - e. Përdorimin e të dhënave personale/gjenealiteteve të tjera.



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve konstaton se, nga verifikimet e kryera nga Prokuroria e Përgjithshme subjekti deklarues z. Adrian Vullnet Gjoka, është dënuar me **3 (tre) muaj burgim**, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin gjyqësor jopërfundimtar nr. 654, datë 05.03.2021 për veprën penale të “Falsifikimit të dokumentave”, parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal.

Vepra penale “Falsifikim i dokumentave”, parashikuar nga neni 186/1 për të cilën është dënuar kandidati për deputet si dhe masa e dënimit 3 (tre) muaj burgim nuk përfshihet në asnjë nga rastet e ndalimeve të parashikuara në nenin 2 të ligjit nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë.

Për sa më sipër, referuar të dhënave të deklaruara në formularin e vetëdeklarimit, përgjigjes të ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Burjeve si dhe konkluzioneve të Prokurorisë së Përgjithshme, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se, subjekti deklarues z. Adrian Vullnet Gjoka nuk përfshihet në fushën e veprimit të nenit 2 të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”,

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pikën 12, të Kreut V, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”,



Data: 01 Maj 2021  
Nr. 330

Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme për subjektin vetëdeklarues z. Adrian Vullnet Gjoka, kandidat për deputet i subjektit politik, partia Lëvizja për Ndryshim, Qarku Vlorë, në zbatim të ligjit nr. 138/2015



## V E N D O S:

1. Konstatimin se, z. Adrian Vullnet Gjoka, kandidat për deputet i subjektit zgjedhor, Partia Lëvizja për Ndryshim, qarku Vlorë, nuk përfshihet në kushtet e ndalimit të parashikuar nga ligji nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen, ose ushtrojnë funksione publike”.
2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

Kopje: 3  
Afati i ruajtjes: 5 vjet  
Punoi:  
I.Osmanaj \_\_\_\_\_  
B.Kodra \_\_\_\_\_  
M.Koja \_\_\_\_\_  
A.Lamçe \_\_\_\_\_  
Y.Merkaj \_\_\_\_\_

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Tiranë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2021



Data: 01 Maj 2021

Nr. 330

Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme për subjektin vetëdeklarues z. Adrian Vullnet Gjoka, kandidat për deputet i subjektit politik, partia Lëvizja për Ndryshim, Qarku Vlorë, në zbatim të ligjit nr. 138/2015